

VENDIM
Nr. 7, datë 1.3.2022

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vitore Tusha	kryetare;
Elsa Toska	anëtare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Altin Binaj	anëtar;
Përparim Kalo	anëtar;
Sonila Bejtja	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 1.3.2022 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 10 (G) 2021 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: Gjykata e Apelit Durrës.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë,
Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë,
Prokuroria e Përgjithshme,
Komiteti Shqiptar i Helsinkit,
Avokati i Popullit.

OBJEKTI: Shfuqizimi i togfjalëshit “për të dënuarin përsëritës për krime të kryera me dashje si dhe” në paragrafin e tretë të nenit 64 të Kodit Penal.

BAZA LIGJORE: Nenet 131, pika 1, shkronja “a”, 134, pika 1, shkronja “dh” dhe 145, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 49, pika 3, shkronja “dh” dhe 68, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Sonila Bejtja, mori në shqyrtim pretendimet e Gjykatës së Apelit Durrës (*gjykata referuese*), e cila ka kërkuar shfuqizimin sipas objektit, parashtrimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Kuvendit të Republikës së Shqipërisë (*Kuvendi*) dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (*Këshilli i Ministrave*), që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, Prokurorisë së Përgjithshme dhe Komitetit Shqiptar të Helsinkit, që kanë kërkuar pranimin e kërkesës, konstatoi mungesën e opinionit *amicus curiae* të Avokatit të Popullit, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN

I

Rrethanat e çështjes

1. Shtetasi D.A., me vendimin nr. 141, datë 12.4.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier është dënuar për veprën penale “*Vrasja me paramendim*”, të parashikuar nga neni 78, pika 1, i Kodit Penal (*KP*) dhe është dënuar me 12 vjet burgim.

2. Gjatë kohës që ka qenë duke vuajtur dënimin penal, me vendimin nr. (13-2018-1561) 208, datë 16.3.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan ai është deklaruar fajtor për veprat penale “*Prodhimi*

dhe shitja e narkotikëve”, të parashikuar nga neni 283, pika 1, i KP-së, duke u dënuar me 5 vjet burgim dhe *“Futja ose mbajtja e sendeve të ndaluara në institucionin e ekzekutimit të vendimeve me burgim”*, të parashikuar nga neni 324/a, pika 1, i KP-së, duke u dënuar me 1 vit burgim. Pas bashkimit të dënimeve për këto vepra penale, sipas nenit 55 të KP-së, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan e ka dënuar shtetasin D.A. me 6 vjet burgim. Në zbatim edhe të nenit 56, pika 2, të KP-së, duke bashkuar dënimin e ri me pjesën e mbetur të dënimit që po vuante i pandehuri, gjykata e ka dënuar atë përfundimisht me 7 vjet burgim.

3. Me vendimin nr. 10-2018-1318 (319), datë 28.6.2018, Gjykata e Apelit Durrës ka vendosur lënie në fuqi të vendimit nr. (13-2018-1561) 208, datë 16.3.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe ka caktuar si masë dënimi për të pandehurin, sipas neneve 55 e 56, pika 2, të KP-së, 5 vjet burgim.

4. Duke qenë se nga ky dënim i kishin mbetur pa vuajtur 1 vit, 6 muaj dhe 15 ditë burgim, me kërkesën e datës 8.9.2020 shtetasi D.A. i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë për lirim dhe tij me kusht sipas nenit 64 të KP-së.

5. Me vendimin nr. 12-2021-23 (22), datë 12.1.2021, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë ka vendosur rrëzimin e kërkesës, duke arsyetuar: *“I dënuari ndodhet në kushtet e ndalesës ligjore për të përfituar lirim me kusht, sipas paragrafit të tretë të nenit 64 të KP-së, pasi është përsëritës për veprat penale të llojit krime të kryera me dashje dhe se sjellja e kërkuarit në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) Rrogozhinë nuk ka qenë e tillë që të legjitimojë lirim dhe tij me kusht, duke sjellë në vëmendje masën disiplinore të marrë me datë 5.11.2019 dhe raportin negativ të vlerësimit të Shërbimit të Provës Kavajë.”* Kundër këtij vendimi shtetasi D.A. ka paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Durrës.

6. Në seancën gjyqësore të datës 26.7.2021, gjykata referuese u ka kërkuar palëve të shfaqin mendimin e tyre rreth kushtetutshmërisë së shprehjes *“për të dënuarin përsëritës për krime të kryera me dashje si dhe”* në paragrafin e tretë të nenit 64 të KP-së. Në përfundim të kësaj seance, ndërsa prokurori e ka lënë këtë çështje në vlerësim të gjykatës, mbrojtësi i caktuar kryesisht është shprehur se dispozita penale që ndalon në mënyrë kategorike të drejtën e të pandehurit për të përfituar nga liri me kusht cenon të drejtat e njeriut dhe se janë kushtet për shqyrtimin e çështjes nga Gjykata Kushtetuese (*Gjykata*).

7. Me vendimin e datës 26.7.2021, gjykata referuese ka vendosur pezullimin e gjykimit të çështjes penale nr. 224/2021 dhe i është drejtuar Gjykatës për iniciimin e kontrollit incidental të normës ligjore, duke kërkuar shfuqizimin e shprehjes *“për të dënuarin përsëritës për krime të kryera me dashje si dhe...”* në paragrafin e tretë të nenit 64 të KP-së, i cili parashikon se *“nuk lejohet liri me kusht për të dënuarin përsëritës për krime të kryera me dashje, si dhe për të dënuarin për kryerjen e veprave penale të parashikuara në nenet 78/a, 79/a, 79/b, 79/c apo paragrafi i tretë i nenit 100”*, si dhe ka kërkuar zgjerimin e objektit të kontrollit nga Gjykata për të tërë paragrafin e tretë të nenit 64 të KP-së dhe pikën 3 të nenit 65 të KP-së.

8. Kolegji i Gjykatës, në mbledhjen e datës 19.10.2021, bazuar në nenin 31, pika 3, të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur kalimin e kërkesës për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve. Kjo e fundit, me vendimin e datës 13.12.2021, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë dokumentesh. Mbledhja e Gjyqtarëve me të njëjtin vendim ka pranuar kërkesën e Komitetit Shqiptar të Helsinkit për të ndërhyrë në këtë gjykim si subjekt i interesuar, e po ashtu ka vendosur të kërkojë opinion *amicus curiae* nga Avokati i Popullit.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

9. **Gjykata referuese** ka parashtruar, në mënyrë të përmbledhur, se dispozita objekt kërkesë bie në kundërshtim me:

9.1 *Të drejtën për të mos iu nënshtruar torturës, dënimit apo trajtimit çnjerëzor ose poshtërues*, të sanksionuar në nenin 25 të Kushtetutës, për shkak të ndalimit të mundësisë të të dënuarit për të rifituar në një të ardhme lirinë, për sa kohë që konsiderohet se risocializimi i kujtudo të dënuari përbën një detyrim kushtetues kundrejt dinjitetit të individit.

9.2 *Parimin e proporcionalitetit*, të sanksionuar në nenin 17 të Kushtetutës, pasi ndalimi i zbatimit të lirimit me kusht për përsëritësin e krimit me dashje nuk justifikon mjetin e përdorur me qëllimin që kërkohet të arrihet dhe prezumon se dënimi i parë i marrë nga i dënuari nuk ka arritur qëllimin penal të rikthimit të tij në shoqëri si person i risocializuar.

9.3 *Parimin e drejtësisë në caktimin e dënimit penal*, pasi parashikimi i dispozitës së kundërshtuar bie ndesh me pavarësinë funksionale të gjykatës në përcaktimin e përgjegjësisë penale dhe në individualizimin e dënimit penal, si dhe vetë pavarësinë funksionale të pushtetit gjyqësor.

9.4 *Parimin e barazisë përpara ligjit*, të sanksionuar në nenin 18 të Kushtetutës dhe nenin 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), pasi kufizimi kategorik i lirimit me kusht për të dënuarin për një krim të kryer me dashje nuk e lejon atë të përfitojë nga ky institut, megjithëse mund të ketë plotësuar njëloj kushtet e rehabilitimit sikurse autorët përsëritës të veprave penale të kryera njëherësh në të njëjtin procedim ose procedime të ndryshme, vendimet e dënimit të të cilëve nuk kanë marrë formë të prerë.

9.5 *Të drejtën e trajtimit njerëzor dhe respektimin e dinjitetit të personit që i është hequr liria*, të sanksionuar në nenin 28, pika 5, të Kushtetutës, për shkak të ndalimit absolut të zbatimit të lirimit me kusht si dënim alternativ, ndërkohë që ky institut duhet të shërbejë si një mundësi për të dënuarin me burgim që pas ekzekutimit të një pjese të dënimit të ketë mundësinë që të risocializohet.

9.6 Ndalimet kategorike ligjore të zbatimit të lirimit me kusht janë identike si për dënimin me burgim sipas nenit 64 të KP-së, ashtu edhe për dënimin me burgim të përjetshëm sipas nenit 65 të KP-së. Përveçse kufizimet objektive me llojet/listimin e veprave penale gjenden njëloj të rregulluara në paragrafin e tretë të nenit 64 dhe në pikën 3 të nenit 65 të KP-së, ndalimi i lirimit me kusht për të dënuarit recidivistë për krime të kryera me dashje, edhe pse përmendet vetëm në nenin 64 dhe jo në nenin 65 të KP-së zbatohet *mutatis mutandis* dhe në mënyrë komplementare edhe për të dënuarit me burgim të përjetshëm. Edhe argumentet kushtetuese për papajtueshmërinë e tyre janë identike, për rrjedhojë analiza duhet të shtrihet edhe në pjesën tjetër të paragrafit të tretë të nenit 64 dhe në pikën 3 të nenit 65 të KP-së, edhe pse këto parashikime nuk kanë relevancë për zgjidhjen e çështjes objekt gjykimi. Lirimi me kusht si mundësi ligjore e pamundësuar nga nenet 64 dhe 65 të KP-së e shndërron dënimin me burgim të përjetshëm në këto raste në dënim me burgim deri në vdekje, i cili është njëloj i papajtueshëm me Kushtetutën dhe KEDNJ-së sikurse dënimi me vdekje. Për rrjedhojë, kufizimi kategorik dhe aprioristik i zbatimit të lirimit me kusht sipas këtyre dispozitave është i papajtueshëm me Kushtetutën dhe të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për zbatim.

10. ***Subjekti i interesuar, Kuvendi***, ka prapësuar si vijon:

10.1 Lirimi me kusht nuk është një e drejtë kushtetuese për personat të cilëve u është hequr liria, në bazë të nenit 27, pika 2, shkronja “a”, të Kushtetutës dhe nuk është detyrim i shtetit që t’ua garantojë këtë të drejtë. Vendosja e sistemit të lirimit me kusht është një e drejtë e organit legjislativ, i cili gëzon një hapësirë të gjerë vlerësimi dhe është në diskrecionin e tij, brenda konceptit të politikës penale.

10.2 Pretendimi për cenimin e parimit të proporcionalitetit është i pabazuar, pasi ndërhyrja e ligjvënësit është plotësisht proporcionale. Këta individë nuk përfitojnë nga lirimi me kusht, por mund të përfitojnë nga norma të tjera ligjore.

10.3 Qëllimi i paragrafit të tretë të nenit 64 të KP-së nuk është kufizimi i kompetencës së gjykatës, por mbrojtja e të drejtave themelore të shoqërisë dhe rehabilitimi i personave të dënuar që shfaqin rrezikshmëri të theksuar në shoqëri. Ky parashikim nuk cenon të drejtën e gjykatës për individualizimin e dënimit të autorit të veprës penale, por shqyrtimi i kërkesës për lirim me kusht është një moment që i takon fazës procedurale të ekzekutimit të vendimit.

10.4 Pretendimi se të dënuarit nuk i mundësohet rehabilitimi gjatë vuajtjes së dënimit nuk qëndron, pasi lirimi me kusht nuk ka si qëllim kryesor rehabilitimin e të burgosurit, por pasi vërtetohet rehabilitimi i tij i jepet mundësia e riintegrit në shoqëri. Pra, i dënuari duhet paraprakisht të vërtetohet se është rehabilituar dhe më pas i miratohet kërkesa për lirim me kusht.

10.5 Ndalimi i përfitimit të lirimit me kusht nuk përbën shkelje të nenit 25 të Kushtetutës, pasi nuk shkakton torturë, trajtim degradues ose çnjerëzor për atë kohë sa vetë personi me vullnetin e tij ka hequr dorë nga kjo e drejtë duke kryer vepra të tjera penale me dashje.

10.6 Pretendimi për cenimin e parimit të barazisë për shkak të trajtimit në mënyrë të ndryshme të personave që janë dënuar më parë dhe janë përsëritës të veprave penale dhe personave që kanë kryer disa vepra penale dhe dënohen me një vendim të vetëm është i pabazuar, pasi subjektet kanë statute të ndryshme. Ligjvënësi ka ndaluar përfitimin nga lirimi me kusht për të gjithë autorët përsëritës të veprave penale me dashje.

11. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka prapësuar si vijon:

11.1 Gjykata referuese nuk legjitimohet, pasi shtetasi D.A. është liruar në datën 21.11.2021 nga IEVP-ja, Rrogozhinë, për rrjedhojë asaj i mungon legjitimimi, pasi nuk ka më mosmarrëveshje kushtetuese për t'u zgjidhur nga Gjykata.

11.2 Lirimi me kusht nuk është një e drejtë kushtetuese për personat të cilëve u është hequr liria, në bazë të nenit 27, pika 2, shkronja "a", të Kushtetutës dhe nuk është detyrim i shtetit që t'ua garantojë këtë të drejtë. Vendosja e sistemit të lirimit me kusht është në diskrecion të organit legjislativ, i cili gëzon një hapësirë të gjerë vlerësimi, brenda konceptit të politikës penale.

11.3 Pretendimi për cenimin e parimit të proporcionalitetit është i pabazuar, pasi ndërhyrja e ligjvënësit është plotësisht proporcionale. Këta individë nuk përfitojnë nga lirimi me kusht, por mund të përfitojnë nga norma të tjera ligjore.

11.4 Pretendimi se të dënuarit nuk i mundësohet rehabilitimi gjatë vuajtjes së dënimit nuk qëndron, pasi lirimi me kusht nuk ka si qëllim kryesor rehabilitimin e të burgosurit, por pasi vërtetohet rehabilitimi i tij i jepet mundësia e riintegritimit në shoqëri.

11.5 Pretendimi për cenimin e parimit të barazisë për shkak të trajtimit në mënyrë të ndryshme të personave që janë dënuar më parë dhe janë përsëritës të veprave penale dhe personave që kanë kryer disa vepra penale dhe dënohen me një vendim të vetëm është i pabazuar, pasi subjektet kanë statute të ndryshme. Ligjvënësi ka ndaluar përfitimin nga lirimi me kusht për të gjithë autorët përsëritës të veprave penale me dashje.

12. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, në mënyrë të përmbledhur ka parashtruar si vijon:

12.1 Gjykata referuese legjitimohet për të vënë në lëvizje gjykimin kushtetues, pasi ka përmbushur kërkesat formale që parashikon Kushtetuta dhe ligji. Ajo ka identifikuar ligjin e zbatueshëm për zgjidhjen e çështjes konkrete, ka paraqitur arsye serioze të antikushtetutshmërisë së tij, si dhe ka dhënë argumente për pamundësinë e zgjidhjes së çështjes në mungesë të vendimarrjes së Gjykatës.

12.2 Ndalimi në mënyrë kategorike i zbatimit të lirimit me kusht, sipas nenit 64 të KP-së, bie në kundërshtim me nenin 3 të KEDNJ-së dhe jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, pasi nuk u jep mundësi gjykatave të rishqyrtojnë dënimin në fazën e ekzekutimit të tij për këtë kategori të dënuarish. Ai i heq mundësinë dhe diskrecionin gjykatës të vlerësojë ecurinë e ekzekutimit të dënimit dhe sjelljen e të dënuarit. Duke ndërhyrë në atributet e gjykatës për caktimin dhe individualizimin e dënimit penal cenohet edhe parimi i ndarjes së pushteteve.

12.3 Ky ndalim bie në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit, pasi cenon balancën midis së drejtës të kufizuar të individit dhe interesit publik, lidhur me të drejtën e shtetit për të siguruar rendin publik dhe shoqëror. Duke mos i dhënë mundësinë të dënuarit të kërkojë rivlerësimin e dënimit në përputhje me nivelin e riedukimit të tij nuk mund të pretendohet që ai ta perceptojë të drejtë atë, për pasojë të arrihet një proces riedukimi i suksesshëm.

12.4 Kontrolli kushtetues duhet të zgjerohet edhe ndaj parashikimeve të pjesës së dytë të paragrafit të tretë të nenit 64 të KP-së dhe të pikës së tretë të nenit 65 të KP-së, që parashikojnë ndalimin për përfitimin nga instituti i lirimit para kohe me kusht për kategorinë e veprave penale të parashikuara në nenet 78/a, 79/a, 79/b, 79/c dhe paragrafin e tretë të nenit 100 të KP-së.

13. **Subjekti i interesuar, Komiteti Shqiptar i Helsinkit**, në mënyrë të përmbledhur ka parashtruar si vijon:

13.1 Kontrolli kushtetues i Gjykatës duhet të shtrihet jo vetëm ndaj pjesës së dytë të paragrafit të tretë të nenit 64 të KP-së, por edhe ndaj pikës së tretë të nenit 65 të KP-së, pasi këto parashikime ligjore përmbajnë ndalime absolute të përfitimit nga instituti penal i lirimit me kusht për kategorinë e të dënuarve përsëritës për krime të kryera me dashje si edhe për të dënuarit për kryerjen e veprave penale të parashikuara në nenet 78/a, 79/a, 79/b, 79/c dhe paragrafin e tretë të nenit 100 të KP-së.

13.2 Nenet 64 dhe 65 të KP-së nuk respektojnë parimin e barazisë midis të dënuarve në lidhje me të drejtën e tyre për t'u rehabilituar dhe riintegruar në shoqëri, pasi të dënuarit përsëritës për krime të kryera me dashje i ndalohet kategorikisht e drejta për të kërkuar lirimin me kusht në raport me një person tjetër, i dënuar me burgim të përjetshëm, që ka vuajtur më shumë se dyfishin e dënimit, sipas parashikimeve të nenit 65, paragrafi 2, të KP-së.

14. **Subjekti i interesuar, Avokati i Popullit**, të cilit Gjykata i ka kërkuar një opinion *amicus curiae*, nuk ka paraqitur mendim në lidhje me këtë çështje, edhe pse është njoftuar rregullisht.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e gjykatës referuese

15. Gjykata vëren se nenet 145, pika 2 dhe 134, pika 1, shkronja “dh”, të Kushtetutës u njohin të drejtën gjyqtarëve që gjatë gjykimit, kur ata çmojnë se ligjet bien në kundërshtim me Kushtetutën, të mos i zbatojnë ato, duke vendosur pezullimin e çështjes dhe dërgimin e saj Gjykatës Kushtetuese.

16. Përmbajtja e kësaj dispozite ka të bëjë me kontrollin kushtetues të ligjeve të realizuar nga kjo Gjykatë, por që për iniciues ka gjykatat e sistemit të zakonshëm, të cilat pezullojnë gjykimin kur gjatë shqyrtimit të një çështjeje gjyqësore ende të pazgjidhur, përfundimi i së cilës varet nga ligji konkret, çmojnë se ligji nuk është i pajtueshëm me Kushtetutën (*shih vendimin nr. 4, datë 23.1.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se, bazuar në nenin 145, pika 2, të Kushtetutës, i konkretizuar në nenin 68 të ligjit nr. 8577/2000, që të legjitimohet gjykata referuese për iniciimin e kontrollit incidental të normës ligjore për papajtueshmëri me Kushtetutën, duhet që gjatë procesit gjyqësor: i. të ketë përcaktuar/identifikuar ligjin që do të zbatohet për zgjidhjen e çështjes konkrete; ii. të parashtojë arsye serioze për antikushtetutshmërinë e këtij ligji, duke referuar në normat ose parimet konkrete të Kushtetutës; iii. të ketë krijuar bindjen se gjykimi nga ajo nuk mund të përfundojë në mënyrë të pavarur nga gjykimi në Gjykatën Kushtetuese; iv. të ketë hetuar nëse ka dispozita të tjera për të zgjidhur çështjen në gjykim dhe, nëse arrin në konkluzionin se ky është ligji i vetëm të cilit duhet t'i referohet për zgjidhjen e çështjes, të bëjë të gjitha përpjekjet për ta interpretuar atë në përputhje me Kushtetutën (*shih vendimet nr. 7, datë 23.2.2021; nr. 8, datë 7.2.2017; nr. 22, datë 11.4.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Kriteret e përcaktuara nga jurisprudenca kushtetuese janë kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht, çka nënkupton se gjykata referuese duhet të evidentojë jo vetëm objektin, por edhe standardin kushtetues të cenuar në funksion të inicimit të gjykimit kushtetues, pra jo vetëm normën ligjore, por edhe parimet ose standardet kushtetuese që ajo cenon në rast se zbatohet për zgjidhjen e çështjes. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i vetëm njërit prej kriterëve kushtetuese që gjykata referuese të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues (*shih vendimin nr. 8, datë 7.2.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Gjykata vëren se në rastin në shqyrtim në objekt dhe në përmbajtje të kërkesës, gjykata referuese ka identifikuar nenet 64 dhe 65 të KP-së, për rrjedhojë ajo, në kuptim të legjitimitimit, do të analizojë lidhjen e drejtpërdrejtë të këtyre dispozitave me zgjidhjen e çështjes konkrete nga gjykata referuese.

19. Gjykata vëren se objekti dhe shkaqet e kërkesës, me të cilat ngrihet çështja e kushtetutshmërisë, përbëjnë thelbin (*thema decidendum*) e gjykimit kushtetues (*shih vendimin nr. 22, datë 11.4.2016, të Gjykatës*

Kushtetuese). Në këtë kuptim, në objektin e kërkesës gjykata referuese ka kërkuar shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën të shprehjes “... nuk lejohet lirimi me kusht për të dënuarin përsëritës për krime të kryera me dashje, si dhe ...” në paragrafin e tretë të nenit 64 të KP-së, ndërkohë që në përmbajtje të kërkesës, për të njëjtat shkaqe, ka kërkuar zgjerimin e këtij objekti ndaj të gjithë paragrafit të tretë të këtij neni, si dhe pikës 3 të nenit 65 të KP-së.

20. Në lidhje me legjitimitimin e gjykatës referuese për kontrollin e pajtueshmërisë me Kushtetutën të përmbajtjes së shprehjes “për të dënuarin përsëritës për krime të kryera me dashje si dhe” në paragrafin e tretë të nenit 64 të KP-së, Gjykata, bazuar në aktet e dosjes gjyqësore të dërguar së bashku me vendimin për pezullimin e gjykimit të çështjes, vëren se gjykata referuese është vënë në lëvizje bazuar në ankimin e shtetasit D.A. (i dënuar me vendim të formës së prerë), i cili ka kundërshtuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë që ka vendosur rrëzimin e kërkesës së tij për lirim me kusht, me arsyetimin se ky i dënuar ndodhet në kushtet e ndalesës ligjore sipas paragrafit të tretë të nenit 64 të KP-së, pasi është përsëritës për veprat penale të llojit krime të kryera me dashje, dhe se sjellja e tij në IEVP-në Rrogozhinë nuk ka qenë e tillë që të legjitimojë lirim me kusht.

21. Sipas paragrafit të tretë të nenit 64 të KP-së, që rregullon institutin e lirit me kusht, “Nuk lejohet lirimi me kusht për të dënuarin përsëritës për krime të kryera me dashje si dhe për të dënuarit për kryerjen e veprave penale të parashikuara në nenet 78/a, 79/a, 79/b, 79/c apo paragrafin e tretë i nenit 100.”.

22. Referuar kriterëve të legjitimit, nga përmbajtja e këtij paragrafi, që në mënyrë të shprehur ka parashikuar ndalimin e zbatimit të këtij instituti në rastet kur i dënuari është përsëritës për krime të kryera me dashje dhe nuk e lejon gjykatën e zakonshme të vlerësojë historikun e vuajtjes së dënimit dhe sjelljen e të dënuarit gjatë viteve të vuajtjes së dënimit, Gjykata konstaton se kjo është dispozita e zbatueshme në rastin konkret për zgjidhjen e çështjes nga gjykata referuese, për rrjedhojë është respektuar kërkesa për identifikimin e ligjit të zbatueshëm për zgjidhjen e çështjes konkrete.

23. Gjykata vëren se për sa i takon kriterit që gjykata referuese të ketë krijuar bindjen se gjykimi nga ajo nuk mund të përfundojë në mënyrë të pavarur nga gjykimi në këtë Gjykatë, sipas shkresës 473/2, datë 1.2.2022 të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, një provë e re kjo e administruar në seancë për nevoja të këtij gjykimi, rezulton se shtetasi D.A. ka përfunduar dënimin në datën 21.11.2021 dhe është liruar nga IEVP-ja Rrogozhinë. Në këto kushte, çështja gjyqësore penale në shqyrtim në gjykatën referuese ka mbetur pa objekt për shkak të lirit nga burgu të të dënuarit. Për rrjedhojë, duke konsideruar se vendimi i kësaj Gjykate nuk mund të sjellë asnjë pasojë në lidhje me zgjidhjen e çështjes konkrete në shqyrtim nga gjykata referuese dhe as për të drejtat e të dënuarit, të cilat kërkojnë të mbrohen nëpërmjet këtij gjykimi incidental, si dhe në situatën që çështja ka marrë zgjidhje për shkak të një rrethane tjetër, Gjykata vlerëson se gjykata referuese nuk ka më interes për kontrollin e kushtetutshmërisë së shprehjes “për të dënuarin përsëritës për krime të kryera me dashje si dhe” në paragrafin e tretë të nenit 64 të KP-së.

24. Gjykata referuese ka kërkuar sipas nenit 48 të ligjit nr. 8577/2000 edhe shfuqizimin e paragrafit të tretë të nenit 64 të KP-së, si dhe të pikës 3 të nenit 65 të KP-së, që i referohet ndalimit të lirit me kusht për të dënuarin me burgim të përjetshëm edhe pse këto parashikime nuk janë të zbatueshme në çështjen konkrete që po shqyrton gjykata referuese. Për sa më sipër, në kushtet kur gjykata referuese nuk ka më çështje për zgjidhje para saj në kuptim të përmbajtjes së nenit 64 të KP-së dhe në këto kushte i mungon lidhja e drejtpërdrejtë mes çështjes së kushtetutshmërisë të kësaj dispozite dhe zgjidhjes së çështjes konkrete, Gjykata nuk merr në shqyrtim as përmbajtjen e nenit 65 të KP-së.

25. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se kërkesa e gjykatës referuese duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “a”, 134, pikat 1, shkronja “dh” dhe pika 2, nenit 145, pika 2, të Kushtetutës, si dhe neneve 68, 72 e vijuese

të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 1.3.2022.

Shpallur më 30.3.2022.

Kryetare: Vitore Tusha

Anëtarë: Marsida Xhaferllari, Elsa Toska, Altin Binaj, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Përparim Kalo